



SUPPORTING EMPLOYMENT OF YOUNG PEOPLE



This project is funded by the European Union

Agjencia e Punësimit të Republikës së Maqedonisë (APRM), në suaza të implementimit ekzistues të projektit “Mbështetja për punësimin e të rinjve”, të financuar nga BE-ja, bën:

SHPALLJE PUBLIKE

për regjistrimin e të papunëve për të marrë pjesë në Stërvitjen dhe këshillimin për afarizëm

U bëhet thirrje të gjithë personave të papunë, të regjistruar si kërkues aktiv të punës të moshës deri 29 vjet, të cilët së paku e kanë mbaruar shkollën e mesme, që të marrin pjesë në

- Stërvitjen dhe këshillimin për afarizëm (për 950 veta)

Kjo stërvitje do t’u mundësojë 950 vetave të fitojnë njohuri të nevojshme në fushën e afarizmit, dhe të përpilojnë planin e biznesit për vetëpunësim të suksesshëm.

Stërvitjet dhe këshillimet për afarizëm do të implementohen nga ana e provajderëve trajnues të zgjedhur në mbarë territorin e shtetit.

Procedura e aplikimit

Të gjithë personat e papunë, të regjistruar në Agjencinë e Punësimit si kërkues aktiv të punës, të moshës deri 29 vjet, të cilët janë të interesuar për të marrë pjesë në këtë stërvitje, mund të plotësojnë aplikacion për pjesëmarrje në Agjencinë e Punësimit ose në qendrat e punësimit brenda shtetit.

Secili kandidat, për të marrë pjesë në stërvitje duhet t’i plotësojë kriteret siç vijojnë:

- Të jetë i moshës deri 29 vjet
- Të jetë i regjistruar në Agjencinë e Punësimit si kërkues aktiv i punës
- Së paku të ketë mbaruar shkollën e mesme
- Të ketë deklaruar në planin individual të punësimit (PIP) se dëshiron të marrë pjesë në përgatitjen për punësim

Përzgjedhja përfundimtare e pjesëmarrësve në stërvitje do të bëhet nga ana e komisionit të evaluimit në përputhje me kriteret e lartpërmendura, duke formuar listën ranguese të të gjithë kandidatëve të miratuar.

Në qoftë se numri i personave, të cilët janë të interesuar për pjesëmarrje në këtë stërvitje, e tejkalon atë që është paraparë, atëherë përparësi do t’u jepet personave të papunë të cilët një kohë më të gjatë kanë qenë të regjistruar si të papunë në Agjencinë e Punësimit.

Personat të cilët deri tani nuk kanë marrë pjesë në stërvitje të këtilla, inkurajohen për t’u paraqitur për pjesëmarrje.

Agjencia e Punësimit i inkurajon të gjithë personat e papunë të moshës deri 29 vjet, së paku që e kanë mbaruar shkollën e mesme, e që u pëkasin gjinive, nacionaliteteve dhe kulturave të ndryshme, të aplikojnë me qëllim që t’i përmirësojnë njohuritë e tyre për afarizmin dhe të përpilojnë planin e biznesit për vetëpunësim. Personat e grupeve të pakicave, si dhe personat me nevoja të posaçme inkurajohen që të aplikojnë.

Agjencia e Punësimit e ruan të drejtën që t’i refuzojë kandidatët të cilët nuk i plotësojnë kriteret e nevojshme.

Afati i fundit i aplikimit

Personat e papunë deri në moshën 29 vjet, të cilët janë të interesuar, e që janë të regjistruar si kërkues aktiv të punës, së paku që e kanë mbaruar shkollën e mesme, mund të dorëzojnë



This project is implemented by



Employment Service Agency



SUPPORTING EMPLOYMENT OF YOUNG PEOPLE



This project is funded by the European Union

aplikacion për pjesëmarrje në Agjencinë e Punësimit ose në 30 qendrat e punësimit, çdo ditë pune prej orës 8:30 deri 16:30.

Aplikacionet e pjesëmarrësve do të evaluohen mesatarisht një herë në muaj. Shpallja publike do të jetë e hapur deri në plotësimin e numrit të planifikuar të personave për këtë masë (950 veta).

Secili person i papunë i zgjedhur për të marrë pjesë në këtë masë, do të nënshkruajë marrëveshje për pjesëmarrje në stërvitje. Personat që do ta mbarojnë me sukses këtë stërvitje, do të marrin certifikatë për pjesëmarrje në stërvitje dhe për përpilimin e planit të biznesit, me çka do të mund të marrin pjesë drejtpërdrejt në programin e vetëpunësimit.

Aktivitetet e projektit ndihmojnë drejtpërdrejt në arritjen e qëllimeve të Planit operativ për masat aktive në tregun e punës gjatë vitit 2017.

Shpallja publike është publikuar edhe në këto ueb faqe:

- Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë www.avrm.gov.mk
- Ministria e Punës dhe Politikës Sociale www.mtsp.gov.mk

